

QËNDISTARIA
Tefta **PRIFTI**
Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Ashtu si 578 vite më parë, prijësit arbëror u mbledhën në Lezhë për të mbrojtur vendin nga pushtuesit edhe ne sot jemi mbledhur këtu për të treguar rrënjët tona dhe për ti përcjellë ato tek brezat e rinj. Edhe unë si një artizane qëndistare e cila ka një eksperiencë mbi 40 vjeçare që merrem me këtë zeje dëshiroj që këtë profesion edhe këto veshje ti shikoj tek të rinjtë tanë të cilët sot po përballen me kulturat e tjera perëndimore e më gjerë edhe po i duket vetja sikur ne nuk kemi kulturë apo trashëgimi të pasur me të cilën të krenohemi përballë të tjerëve, por jo, ne kemi që në kohën e ilirëve, të arbërve e tani të shqiptarëve kulturë e tradita shumë të lakmueshme nga të tjerët.

Fjalë kyçe: qëndis, brez, artizane.

ABSTRACT

Just like 578 years ago, Arberian leaders gathered in Lezha to defend the country from invaders and today we are gathered here to show our roots and to pass them on to the younger generations. As an embroidered artisan who has over 40 years of experience dealing with this craft, I want to see this profession and these clothes in our young people who today are facing other western cultures and beyond and are looking at themselves. as if we do not have a rich culture or heritage with which to be proud in front of others, but no, we have since the time of the Illyrians, Arbërs and now Albanians a culture and traditions very enviable by others.

Key words: knit, generation, artisan.

HYRJJE

Veshja jonë përshembull është një nga vlerat tona kulturore më të çmuara e cila vërtetohet shumë mirë me anë të zbulimeve arkeologjike, gjë e cila tregon vazhdimësi që nga ilirët e deri tani. Statuja e një gruaje me veshje ilire e zbuluar në dimal, na jep një pamje të veshjes së gruas ilire, të cilën e trashëgojmë edhe ne, normalisht me ndryshimet dhe përshtatjet me kohën. Berati, qyteti 2400 vjeçar, zuri vend në zvillimin e historisë dhe u konfirmua për vlera që mbart në shekuj. Gjithashtu u bë qëndër e njohur zejtare tregetare e zhvilluar ku kryhej shitblerja e çdo lloji zejtar berati qytet me nivel kulturor kishte kërkesa të larta për mënyren e jetesës dhe veshjet të cilat rriten importin në sendet e lukst. Metoda e re perëndimore që po hynte kërkonte dhe specialistë për qepjen e tyre. Kërkoheshin rrobaqepës dhe artizanë fisnikët shqipëtar të cilët dëshironin të përfaqësoheshin denjësisht përballë të tjerëve me veshje sa më të bukura e nxiten edhe më tej zhvillimin e qëndistarisë.

QËNDISTARIA

Berati ishte mjaft i njohur për prodhimin e veshjeve të luksit, të aristokracisë dhe pasanikëve. Veshjet beratase kanë qenë të shumë llojshmërisë si për burra dhe gra. Veshjet më të përhapura për burra kanë qenë: fustanella, tirqet, këmisha, jeleku, mëngorja dhe brezi dhe në këmbë jopinga prej lëkure.

Fustanella u bë shumë e lakmueshme pasi burrat që i vishnin kishin krenari dhe me fustanellë shkonin dhe në oborret mbretërore. Ajo mori përhapje dhe në Evropë për elegancën dhe lehtësinë në përdorim. Ajo përbëhej nga pëlhur e bardhë me 4 fletë, por fisnikëria i përdorte me kinda që shkonin nga 100 deri ne

500 fletë ose kinda me gjatësi sipas dëshirës dhe moshës. Shoqërohej me jelek të qëndisur me gajtan të zi ose me fije ari kjo sipas besimit fetar. Veshja e sipërme ishte guna e përbere prej leshit të dhisë dhe të deles, qepej me kinda dhe e gjatë deri në fund të këmbëve, llogani vetëm me lesh dhie dhe e gjatë përmbi gju gjithashtu bruci ose floktarja që kryente të njëjtin funksion, xhaketat e shumë të tjera.

Veshje tjetër e brendshme e burrave janë *mëngoret* të cilat vishen sipër këmishës dhe jelekut e zbukuruar, dekorative me mëngë jo funksionale si për shembull mëngët me llapa që i përkisnin periudhës bizantine. Ndryshe nga burrat mëngoret e grave kishin mëngët të qepura, gëzhota vishej dhe nga burrat dhe nga gratë me ndryshimin që burrat e kishin të punuar prej shajaku të destiluar dhe gratë me pëlhurë të punuar në tezgjah.

Dolloma, veshje e sipërme e bardhë me mëngë ose pa mëngë, poshtë të cilës vishej këmisha e bardhë e gjatë, gjithashtu dhe cibuni bëhej prej shajaku të bardhë dhe e qëndisur me gajtan sakoja e gjatë, poshtë gjurit dhe sako deri tek kyçi i këmbës. Sakoja është veshje e rënde e qëndisur me ar dhe me gurë të çmuar dhe temina kadifeja ishte copë e veçantë me të cilën bëheshin sakot. Ajo rrinte pas trupit dhe të jepte një elegancë me pamje madhështore. Sakoja pa mëngë vishet me këmishë me mëngë mëndafshi të qëndisura me fije ari. Sakot visheshin dhe me funde kadifeje ose dhe me fustan, ajo shoqëronte dhe nga rripat në kokë dhe tek beli. Të gjitha veshjet e grave shoqëroheshin me qëndisje dhe ngjyrat më të preferuara ishin e kuqja, vishnja, ngjyra vjollcë, blu dhe jeshile. Jelekët janë përdorur si tek burrat ashtu dhe tek gratë. Jelekët visheshin dhe me çitjane.

Çitjane ose tumanet janë pantallona të modës orjentale të cilat shoqërohen me këmbë kadifeje të qëndisura me gajtan gjithashtu dhe bluzat pa jakë ose me jakë te rrumbullakët qëndisen me ar, por fatkeqësisht artizanati shqiptar gjatë shek. të XX mori një goditje të rëndë, duke e çuar atë drejt zhdukjes. Kjo gjë çoi edhe në largimin e veshjes sonë popullore nga përditëshmeria.

PËRFUNDIME

1. Të vishesh me veshje tradicionale popullore nuk do të thotë që të ngelesh mbrapa sepse si çdo gjë tjetër edhe kultura dhe veshja evoluojnë.
2. Edhe unë si qëndistare këtë gjë kam bërë ose jam përpjekur të bëj, të ndërthur veshjen tonë popullore me modernen duke e bërë atë sa më popullore për kohën në të cilën ne jetojmë.
3. Unë jam shpresëplotë se kuvende të tilla do të zgjojnë ndjenjën dhe dëshirën tek të rinjtë për tu kthyer te rrënjët e tyre.